



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 191 / prot.

Tiranë më 2.5.2018

Lënda: Mendim mbi projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar.

MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 8163 Prot., datë 26.04.2018, projektvendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit", të ndryshuar, vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

Vlerësojmë që në çdo formular përkatës të aplikimit, fjalia e parë e paragrafit të tretë, të shtojcës 1, "Formular i deklarimit të të dhënave personale" të zëvendësohet me: "DPPI mund të përdoret herë pas here një nga format e mësipërme të komunikimit për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI".

Gjithashtu, për shkak se në formular përdoret terminologjia e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, paragrafi i katërt duhet të riformulohet: "Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korigjimit ose fshirjes së të dhënave personale që DPPI ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga legjislacioni në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

